



MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIFËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS PUBLIKE

U R D H Ë R

Nr. ~~719~~ / Datë 5 / 10 / 2015

P Ë R

PRISHJEN E SHOQËRISË “ PRODHIM VESHJE USHTARAKE” SH.A, TIRANË

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 1 të Ligjit Nr. 8885, datë 22.4.2002, për disa ndryshime në Ligjin Nr. 7926, datë 20.4.1995 “ Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, ndryshuar me akte të tjera ligjore, dhe Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, për shkak të situatës së vështirë ekonomiko-financiare dhe humbjes së objektit kryesor të aktivitetit, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë “ Prodhim Veshje Ushtarake” sh.a Tiranë,

URDHËROJ:

1. Prishjen e shoqërisë “ Prodhim Veshje Ushtarake” Tiranë dhe shpalljen e saj në likuidim.
2. Likuidator i shoqërisë emërohet Z. Avjeri HOXHAI, aktualisht Administrator i kësaj shoqërie.
3. Të hartohet bilanci i likuidimit në përputhje me dispozitat e ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.
4. Z. Kastriot Haxhaj, Ekspert Kontabël i Autorizuar, të kryejë certifikimin e Bilancit të likuidimit.
5. Ngarkohet likuidatori i shoqërisë për kryerjen e veprimeve përkatëse, në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ARBEN AHMETAJ

MINISTËR





REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E PRIVATIZIMIT

URDHËR

Nr. 9202 Datë 18.11.2016

PËR MBYLLJEN E TË GJITHA VEPRIMEVE TË SHOQËRISË “PRODHIM VESHJE USHTARAKE” SH.A. NË LIKUIDIM

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të Ligjit nr. 8237, datë 01.09.1997 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, i ndryshuar dhe nenit 197, të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, me cilësinë e aksionarit të vetëm,

URDHËROJ :

1. Mbylljen e të gjitha veprimeve të shoqërisë “Prodhim Veshje Ushtarake” sh.a. në likuidim.
2. Në zbatim të pikës 1 të këtij urdhri, Ekspert Kontabël i Autorizuar emërohet Znj. Lindita Muca, për certifikimin e bilancit përfundimtar.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.



MINISTRI

Milva Ekonomi
MILVA EKONOMI

RAPORT

RAPORT I VEÇANTË

Per mbylljen dhe likujdimin e " N P V " SH.A(Shoqeri ne likujdim e siper)

Likujdatore : Avjeri Hoxhaj

E.K.R

Tirane me 30.06.2017

Lindita Muça

LINDITA MUÇA
EKSPERTE MONTARE E REGJISTRUAR
NUIS: L 41419022 Q

Cel

WIRAS

IVTAXI

0

Totale likujdimi

0

Totale likujdimi

0

Totale likujdimi

0

Totale

0

Totale likujdimi

0

Totale

0

Totale likujdimi

0

LINDITA MUÇA
EKSPERTE MONTARE E REGJISTRUAR
NUIS: L 41419022 Q

RAPORT I VECANTE

Per mbylljen dhe likuidimin e " N P V" SH.A(Shoqeri ne likujdim e siper)

I Pranimi I mandatit te likujdatorit.

Bazuar ne Urdhrin 4877/1,date 05.06.2017 te Minsitrit te ZHVILLIMIT Ekonomik ,Tregtise dhe Siper marrjes, bazuar dhe ne miratimin e pasqyrave financiare deri ne 31.12.2016 perkatese ,ku eshte urdheruar : mbyllja perfundimtare e llogarive-miratim per kalimin ne rezultatin financiar te lloagrive debitore dhe kreditore

Konkretisht :

-Te kalojne ne te ardhura llogaria e detyrimeve qe shoqeria i ka Minsitrise, qe jane te ardhura te pa kaluara ne llogarine e buxhetit te shtetit(Ministria).


-Te kalojne ne llogarine e shpenzimeve zeri kerkesa per arketim qe jane detyrime nga subjektet e tjera dhe detyrime nga shteti(tvsh,tatim fitimi etj.)

-te behet mbyllja e detyrimeve qe shoqeria ka ndaj individeve te tjere dhe shtetit.

Bazuar ne kete Shkrese u b mbylla perfundimtare e gjithë llogarive dhe ndryshimet ne kapital te shoqerise.

Reciprokisht te gjitha llogarite jane me vlere zero.

AKTIVI		PASIVI	
I Aktive afat gjata	0	I Totali i kapitali	0
Toka	0	Kapitali Aksioner	0
Ndertesa	0	rezervat ligjore	0
		Rezerva te tjera	0



		Rezultati financiar	0
II Aktive afat shkurtra	0	II Detyrimet	0
Likujditete	0	- te pagueshme ndaj furnitoreve	0
Kerkesa per tu arketuar	0	-te pagueshme ndaj punonjesve	0
Kliente	0	- detyrime per sig,shoq,e shend,	0
Debitore kreditore	0	-detyrime per TAP-in	0
Tvsh	0	detyrime Ministria	0
Iventari	0	detyrime Bashkia	0

Totali I Aktivit 0

Totali I pasivit 0

IV Dokumentimi I veprimeve gjate mbylljes .

Procesi I mbylljes u krye duke pasur parasysh shkresen perkatese te aksioneirt te shoqerise(ministria) duke mbyllur llogarite debitore dhe kreditore te shoqerise. Meqenese keto kerkesa per arketim nuk na ktheheshin ose rimbursoheshin u detyruam qe keto ti kalonim ne shpenzime .


Gjithashtu nisur nga pasivi I pasqyrave financiare ku shoqeria I detyrohej Ministrise per vleren e te ardhuarve te pakaluar ne vite kjo te kalonet ne te ardhura .

Ne perfundim gjithë llogarite e shoqerise jane me zero .

Per sa me siper pohoj

Ne mbyllje te kesaj faze te shkrirjes ,rezulton se shoqeria I ka mbyllur te gjitha zerat e pasqyrave financiare zero

Bashkangjitur eshte bilanci I I kesaj faze te likujdimit.



Likujdator

Avjeri Hoxhaj

Tirane me 30.06.2017

E.K.R

Lindita Muça



Raporti mbi procedurën e Likuidimit

Në bazë të Urdhrit nr. 7190/1, datë 05.10.2015 të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, jam emëruar likuidatori i shoqërisë “Prodhim Veshje Ushtarake” sh.a.. Lidhur me shoqërinë “Prodhim Veshje Ushtarake” sh.a. në likuidim, ju informojmë për sa vijon:

Shoqëria “Prodhim Veshje Ushtarake” sh.a. e regjistruar në QKR (QKB) më 27.01.2009 në bazë të Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar dhe të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar. Kjo shoqëri është regjistruar me NUIS (Numrin Unik të identifikimit të subjektit) J61904044J. Kapitali fillestar i saj ishte 14,219,000 lekë me aksionar Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Për shkak të situatës së vështirë ekonomiko-financiare dhe humbjes së objektit kryesor të aktivitetit, me Urdhrin nr. 7190/1, datë 05.10.2015 “Për prishjen e shoqërisë “Prodhim Veshje Ushtarake” sh.a., Tiranë”, Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë ka urdhëruar prishjen e shoqërisë dhe shpalljen e saj në likuidim.

Në zbatim të neneve 190-205, ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, shoqëritë në likuidim, kanë si objekt të veprimtarisë së tyre, shitjen e aseteve të shoqërisë dhe me këto të ardhura mbulohen shpenzimet për paga, sigurimet shoqërore dhe shlyhen kreditorët duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

Gjithashtu, në zbatim të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, në përfundim të likuidimit, shoqëria bën dorëzimin e bilancit përfundimtar të mbylljes së shoqërisë, në të cilin pre supozohet bërja zero e të gjitha llogarive të bilancit.

Në zbatim ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, të Ligjit nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për Ankandin Publik”, i ndryshuar, VKM-së nr. 1719, datë 17.12.2008 “Për Miratimin e Rregullave të Ankandit Publik”, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 5380, datë 20.07.2011 “Për procedurat e shitjes me ankand publik të aseteve të shoqërive anonime me kapital shtetëror në likuidim, shoqëria ka realizuar shitjen e aseteve të saj, përkatësisht pasuritë me nr. 2/703 dhe nr. 2/730 në zonën Kadastrale 8250, të cilat ishin asetet e vetme.

Në kushtet kur, shoqëria përfundoi shitjen e pasurive, të cilat përbënin burimin e vetëm të të ardhurave të shoqërisë për realizimin e veprimtarisë së saj, me Urdhrin nr. 9202, datë 18.11.2016 “Për mbylljen e të gjitha veprimeve të shoqërisë “Prodhim Veshje Ushtarake” sh.a. në likuidim, të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, është urdhëruar mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë dhe përfundimin e likuidimit.

Në vijim, në zbatim të nenit 200 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 dhe të Urdhrit nr. 9202, datë 18.11.2016, nga ekspert kontabël të regjistruar u audituan pasqyrat financiare të shoqërisë për periudhën 01.11.2015-31.12.2016, si dhe u përgatit raporti për procedurën e likuidimit.



Raporti mbi procedurën e Likuidimit

Gjatë vitit 2016, me të ardhurat e siguruara nga shitja e këtyre aseteve, përkatësisht në shumën 10,755,000 leke, u përballuan shpenzimet dhe u bë shlyerja e detyrimeve të mëposhtme:

- Të pagueshme ndaj punonjësve në shumën 507,331 lekë
- Të pagueshme për detyrimet tatimore në shumën 2,900,284 lekë;
- Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit në shumën 6,833,591 lekë;
- Detyrime ndaj Bashkisë në shumën 589,817 lekë;

Referuar shkresës nr. 4877/1, datë 05.06.2017 të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, kanë kaluar në rezultat veprimet e mëposhtme:

Kalimin në shpenzime të:

- “Të drejta të arkëtueshme, nga njësitë ekonomike brenda grupit” në vlerën 8,464,121 lekë të krijuara para vitit 2004, të cilat janë të pa arkëtueshme;
- “Të drejta të arkëtueshme, të tjera” në vlerën 2,822,586 lekë, të krijuara para vitit 2004, të cilat janë të pa arkëtueshme;
- “TVSH, Tatim Fitimi” në vlerën 2,017,317, humbur e drejta e kërkesës për rimbursim;

Rimarrje në të ardhura:

- “Detyrime Ministria” në vlerën 23,323,585 lekë.

Zëri “Banka/ Arka” është në vlerën 70,173 lekë, të cilat u përdoren për shlyerjen e detyrimit ndaj ekspertit kontabël të autorizuar, i cili ka certifikuar Pasqyrat Financiare për periudhën kontabël 01.11.2015-31.12.2016, 01.01.2017-30.06.2017, si dhe ndaj ekonomistit të punësuar me kohë të pjesshme për të hartuar Pasqyrat Financiare për periudhën kontabël 01.11.2015-31.12.2016 dhe 01.01.2017-30.06.2017.

Që nga muaji Shtator 2016, nuk kam marrë pagë mujore nisur nga shuma e mbetur në “Banka/ Arka”, përkatësisht 70,173 lekë, e cila shërbeu për të bërë vetëm pagesat për ekonomistin dhe ekspertin kontabël(siç sqaruam pak më lartë).

Bilanci i mbylljes së shoqërisë “Prodhim Veshje Ushtarake” sh.a. në likuidim, në datën 20.07.2017 paraqitet në gjendjen zero.

Pas përfundimit të procedurave ligjore për likuidimin e shoqërisë, ju njoftoj përfundimin e likuidimit dhe kërkoj miratimin e raportit të likuidimit, si dhe çregjistrimin e shoqërisë në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 dhe ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007.

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin.

LIKUIDATORI

